



Pranimi / Dorezimi Punimi / Pradato Received / Delivery	03.06.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTKL	3250/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.400/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Malsore Gashi Bajraktari- Kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca- anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.400/2022 e datës 20.04.2022 e parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil, në çështjen juridike "Vërejtje", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.400/2022 e datës 20.04.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet masa disiplinore "Vërejtje për dosjen personale" e datës 17.03.2022 me numër 2022/ZDP/73 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Autoritetit të Aviacionit Civil, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerrë vendim për fshirjen e "Vërejtje për dosjen personale" e datës 17.03.2022 me numër 2022/ZDP/73 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja sipas Akt emërimit të datës 01.01.2012 ankuesja është e sistemuar në vendin e punës "Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim, Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit", në Departamentin për Bashkëpunim, Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit, të cilës me datë 17.03.2022 me numër 2022/ZDP/73 Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, ia ka shqiptuar "Vërejtje për dosjen personale" me arsyetim me mos respektimin e orarit të punës.

Ankuesja e pa kënaqur me vërejtjen me numër 2022/ZDP/73 të datës 17.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil, me datë 20.04.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 2234/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ka përcjell ankesën e ankuesit tek organi i punësimit Autoritetit të Aviacionit Civil ndërsa me datë 12.05.2022, me numër protokollit 2736/22, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Autoritetit të Aviacionit Civil, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 20.04.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Provat shtesë të ankueses së datës 05.05.2022; e-mail i datave 19.04.2022, 12.04.2022, 21.04.2022; Vërejtje për dosje personale; e-mail i datës 25.03.2022, 11.03.2022, 10.03.2022, 09.03.2022, 16.03.2022, 15.03.2022; Akt emërimi i ankueses; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Raporti i prezencës në punë për nëpunësit civil të Aviacionit Civil për muajin janar, shkurt dhe mars si dhe përgjigje në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila e ka kontestuar vërejtjen e datës 17.03.2022 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil me arsyetim për mos respektim të orarit të punës duke shtuar se vërejtja për dosje personale iu është shqiptuar pa marrë parasysh faktet dhe rrethanat, sepse nuk janë marrë parasysh arsyetimi i dhënë lidhur me vonesat në punë pasi që jeton në periferi të qytetit të Prishtinës dhe se shpesh herë komunikacioni është i stërëngarkuar dhe se në ditët kur është vonuar në punë nuk e ka shfrytëzuar kohën e pushimit të drekës/pauzës dhe i ka kompensuar vonesën në punë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet e ankueses për sa i përket "Vërejtje për dosjen personale" e datës 17.03.2022 me numër 2022/ZDP/73 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil dhe duke u bazuar në provat e administruara në lidhje me këtë lëndë, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i bazuara mbi bazë të arsyeve të specifikuar si më poshtë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar pasi që vërejtja e dhënë me shkrim e datës 17.03.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil nuk është bazuar në provat dhe faktet lidhur me mos respektimin e orarit të punës rrjedhimisht nga ankuesja pasi që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës respektivisht në e-mailin e datës 15.03.2022 të ankueses e cila i ka dhënë arsyet lidhur me vonesat e saj në punë, pasi që ankuesja ka pas rast vdekje dhe iu është dashur të udhëtoj relacionin Prishtinë/Gjakovë dhe anasjelltas dhe daljes së parakohshme pak minuta para përfundimit të orarit të rregullt të saj të punës për shkak të mos ngecjes në trafik dhe se në të njëjtën datë 15.03.2022 udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses e falënderon për shpjegimet e dhëna nga ankuesja për vonesa/dalje të punës dhe e porositë që të kujdeset që këto të evidentohen edhe në sistemin e vijueshmërisë në punë. Po ashtu ne baze të dëshmive të ofruara konkretisht e-maileve të dërguara nga Menaxherja e Personelit, dhe listës së vijueshmërisë të gjithë nëpunësve civile është konstatuar se kohe pas kohe ka pasur probleme me funksionimin e aparatit të vijueshmërisë në punë, respektivisht me mos regjistrimin dhe regjistrimin gabimisht të orës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe dëshmive të ofruara në lëndë, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, me rastin e shqiptimit të "Vërejtje për dosjen personale" për ankueses nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike duke mos i konstatuar drejt elementet e përgjegjësive disiplinore, rrjedhimisht nuk ka konstatuar saktë përgjegjësin disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: "*Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, e që në rastin konkret, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, nuk ka marrë për bazë deklarimin e ankueses dhe të dhënat e ofruara në informatën e datës 11.03.2022 dhe 15.03.2022, andaj me të drejte Kolegji konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankueses përveç që nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike ai nuk ka arritur të vërtetoj as gjendjen juridike sepse në Vërejtje për dosjen personale" nuk i është referuar asnjë dispozitive të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, respektivisht nuk ka konstatuar shkeljet e kryera nga ankuesja, gjegjësisht nuk ka konstatuar që me veprimet apo mos veprimet e saj gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka bërë shkelje të lehta apo të rënda-serioze të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë.

Andaj, duke u bazuar në faktet e lartcekura, lidhur me këtë çështje juridike, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se në rastin konkret mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses në masën e shqiptuar "Vërejtje për dosjen personale" ndaj ankueses nuk ka arritur të konstatoj saktë gjendjen faktike por në mënyrë të përgjithshme ju ka referuar nenit 47 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që ka përcaktuar se: "*Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje"*, si dhe të nenit 13 paragrafit 1.1 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, po ashtu Kolegji ka konstatuar se "Vërejtje për dosjen personale" e datës 17.03.2022 nuk e ka arsyetimin e një akti administrativ me shkrim, i cili do të duhej të ishte i bazuar në dispozitat e nenit 48

paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *"1. Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsytimi përmban:.....2.shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi"*, që në rastin konkret Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil i ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje për dosjen personale" të datës 17.03.2022, nuk ka marrë për bazë këto dispozita ligjore dhe se pretendimi ankimore të ankueses në këtë çështje juridike janë të bazuar, nga se në rastin konkret në bazë të provave të lëndës këto dispozita nuk janë marrë parasysh me rastin e shqiptimit të kësaj vërejtje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit "Vërejtje për dosjen personale" e datës 17.03.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil duhet të fshihet nga dosja personale dhe regjistri përkatës në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 51 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.400/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Menaxheres së Personelit në Autoritetit të Aviacionit Civil dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.